



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/164  
Datë: 09.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

*PËR*   
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/164  
Datë: 09.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 34, paragrafi 12. të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ndërlidhur me nenin 99 paragrafin 6 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 17 paragrafi 3. të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 tetor 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Emërohet Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm, Grupi Nr. 58 në këtë përbërje:
  - 1.1. Zade Kuqi, Zyrtare e Lartë për Politikat e Përshkrimit dhe Klasifikimit të Vendeve të Punës, në DMZP/MPB, kryesuese;
  - 1.2. Lebibe Haliti, Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Juridike/MINT, anëtare;
  - 1.3. Sebahate Bushrani, Udhëheqëse e Sektorit për Metale të Çmuara/MINT, anëtare;
  - 1.4. Valon Prebreza, Udhëheqës i Njësisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike/ME, anëtar;
  - 1.5. Genc Hundozi, Organizata të specializuara "Infrakos" anëtar.

Përbërja e anëtareve zëvendësues të Komisionit

- 1.1. Minire Gjokaj, Zyrtare për Administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Informatave të Burimeve Njerëzore në DMZP/MPB;
  - 1.2. Igballe Rexha, Udhëheqëse e Divizionit për Politika Industriale/MINT;
  - 1.3. Zef Dedaj, Udhëheqës i Divizionit për Politika Tregtare/MINT;
  - 1.4. Teuta Morina, Udhëheqëse e Divizionit të BNJ/ATK
  - 1.5. Mehdi Sali, Organizata të specializuara "K&M" ShPK.
2. Komisioni i Pranimit për institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm, Grupi Nr. 58 i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundimin e procedurave që kanë qenë në proces në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik.
3. Anëtarit nga pika 1.5 e këtij Vendimi ka të drejtën e kompensimit sipas nenit 20, paragrafit 1. dhe 2. të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Komisioni i Pranimi për institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm, Grupi Nr. 58 i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtrojë në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Rregulloren Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**  
*PËR*   
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë